



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 982/1 prot.  
2023

Tiranë, më 11. 09.

**V E N D I M**

**Nr. 177, datë 11. 09. 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 162 regj, datë 04.09.2023, të paraqitur nga ankuesi S. M., kundër Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (në vijim IKMT), Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit Tiranë (në vijim IMT) dhe Bashkisë Tiranë, me pretendimin diskriminimin për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi S. M. deklaroi se në vitin 1999 ka blerë një apartament në katin e parë të një ndërtese. Hyrja kishte patur 8-9 shkallë për të aksesuar banesën. Duke qenë se ai është me aftësi të kufizuara (me karrocë), kishte vendosur që me shpenzimet e tij të bëjë nga mbrapa pallatit një shesh pushimi me strehë për të bërë të mundur hyrjen në apartament. Në momentin që ka ndërtuar shesh pushimin së bashku me një strehë, në vitin 2000, ka marrë dakordësinë e banorëve të pallatit, përmes një deklaratë noteriale.

Disa ditë më parë, pra pas 23 vitesh, ankuesi thekson se banorët e pallatit kanë paraqitur ankesë pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, për shesh pushimin e ndërtuar prej tij. Referuar ankimit të banorëve, sqaron se është thirrur nga punonjësi i Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, M. Gj., i cili e ka vënë në dijeni për prishjen e strehës së ndërtuar prej tij. Gjatë takimit me shtetasin M. Gj., ankuesi thekson se i ka paraqitur atij të gjithë dokumentat që dispononte. Pas takimit me ankuesin, punonjësi i Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, pa e vënë në dijeni, i është drejtuar me shkresë IMT-s dhe IKMT-s për ndërtimin pa leje të ankuesit.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ndër të tjera ankuesi thekson se znj. L. B., banore e katit të dytë të pallatit, mban në banesën e saj, por edhe në ambientet e përbashkëta të pallatit, rreth 20-30 mace dhe qen, të cilët kalojnë mbi strehën e ndërtuar prej tij. Sipas ankuesit, këto kafshë kryejnë edhe nevojat personale mbi strehë duke krijuar një ambient të papastër dhe të ndotur. Lidhur me këtë, ankuesi dhe banorët e pallatit i janë drejtuar me ankesë Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, por nuk është marrë asnjë masë. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se znj. L. B., ka paraqitur një denoncim pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, për ti prishur stehën e ndërtuar prej tij rreth 23 vite më parë.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të mos i priset streha e ndërtuar prej tij, nga ana e institucioneve të sipërcituara.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: "***Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.***"

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: "*Diskriminim*" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

*"1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato*  
a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutuar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfutim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;... ”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Më datë 07.09.2023, ankuesi paraqiti një kërkesë me shkrim (e cila u administrua nëpërmjet një procesverbali), nëpërmjet të cilës deklaroi se heq dorë dhe tërhiqet nga çështja objekt shqyrtimi.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pikat 1 dhe 3, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë. ....3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e pales”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 07.09.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 162 regj, datë 04.09.2023, të paraqitur nga ankuesi S. M., kundër Komisionariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit Tiranë dhe Bashkisë Tiranë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarohet të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 162 Regjistri, datë 04.09.2023, paraqitur nga S. M., për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)